- Për automjetin në pronësi: akt pronësie (kontrata/fatura shitblerje ose kontrata dhurimi), leje qarkullimi, akt kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet.
- Për automjetet që nuk janë në pronësi: kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht 12 muaj, leje qarkullimi, akt kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te operoje duke plotesuar standartet ne fuqi per sigurine ushqimore.Per kete ai duhet te paraqese vetdeklarim, ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

2.3.5 Operoret ekonomike duhet te dorezoje dokumenta se ka në pronësi (certificate pronesia) ose në përdorim (kontrate noteriale të objektit qe ka me qira) nje njesi tregetare për magazinimin dhe pergatitjen e mallrave gjate gjithë periudhës te zbatimit të kontratës te mallit.per vete natyren e mallrave qe prishen dhe duhen te fresketa. Ambientet e kerkuara duhet te plotesojne kushtet higjeno-sanitare dhe tekniko teknologjike duke paraqitur Leje higjeno sanitare apo libreze shendetesore.

Ndersa operatori ekonomik i shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates ka detyrimin te paraqese dokumentacionin provues ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet conform kerkesave ligjore .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte

për skualifikim.

Shtojca 9



SPECIFIKIMET TEKNIKE

Te gjitha mallrat ushqimore te jene brenda parametrave dhe standarteve te miratuara nga Ministria e Bujqesise dhe e Ushqimit si me poshte:

Loti 1 : Blerje buke gruri :

Buka e grurit do te prodhohet me miell rreze 70 %, i stazhionuar per nje periudhe prej 10-30 ditesh. Mielli duhet te jete i fresket, me ngjyre, ere , shije dhe lageshtire konforme standarteve perkatese te miellit me rreze 70 %. Mielli nuk duhet te kete asnje lloj lende te huaj. Buka duhe te kete forme te drejte dhe normale, pa deformime dhe siperfaqja e bukes duhet te jete e lemuar dhe pa plasje te ndryshme. Vellimi i bukes duhet te jete i mjeftueshem. Shija, era, lageshtira dhe aciditeti i bukes duhet te jete konforme standartit teknik te prodhiit te saj. Korja e bukes – duhet te jete e lemuar, pa djegie, pa

shkeputje te saj nga tuli, ngjyra e njellojte, mjalti ne te kuqerremte, ne te gjithë siperfaqen. Tuli duhet te jete i pjekur mire, me porozitet te imet ne te gjithë vellimin e tij dhe nuk duhet te kete gjurme mielli te pabrumosura. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me ere te huaj, me shije te hidhur e te tharte, me lende te huaja, me lageshtire jo normale, me shije myku. Treguesit fiziko – kimik: Buka preferohet ne forme katerkendeshe dhe me peshe 0.5 deri ne 1(nje) kg, lageshtira jo me shume se 44.5 %, poroziteti jo me pak se 72%, aciditeti jo me shume se 45%. Furnizimi i bukes do te behet cdo dite prane magazinave te Drejtorise se Sherbimit Spitalor Korce sipas kerkeses. **Amballazhi i transportimit te bukes duhet te jete i paster , te jete ne qese letre dhe te siguroje mos demtimin e saj.** Mjetet transportuese duhet te jene te pastra, te mbyllura qe te sigurohet transportim normal i bukes deri ne destinacionin perkates.

Loti 2: Blerje bylmet dhe veze:

Qumeshti: (i sterilizuar dhe ambalazhuar ne tetra ose prizma pak) duhet te jete brenda standarteve shtetore dhe i certifikuar per konsum. Qumeshti te kete karakteritikat tipike te qumeshtit i cili ka ngjyre pak te verdhe, pa perberes te huaj dhe papasterti te tjera, i kulluar dhe me perqindje yndyre deri ne 2%, aciditet 17 – 19, ngarkesa mikrobike 1 – 2 milion / 1 ml, mbetja e thate 10 – 12. Furnizimi do te behet sipas kerkeses te Drejtorise se Sherbimit Spitalor Kruje me mjetet e furnitorit. Qumeshti duhet te jete i prodhuar e grumbulluar brenda kushteve standarte higjenike te Ministrise se Bujqesise dhe Ministrise se Shendetesise.

Prodhimi te jete i shoqeruar me certifikate te analizet te bere nga laboratorit veterinar.

Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor

Pamja e jashtme Leng i njellojte (homogjen) , pa lende te huaja qe duken e notojne, ose bien ne fund . Me rrjedhje te njellojte dhe pa nderprerje.

Ngjyra . E bardhe e njellojte me nuance te lehte te verdhe .

Shija dhe era .E kendshme , lehtesisht e embel , me shije te lehte zierje, pa shije dhe ere te huaj.

Gjalp i fresket- Bazuar ne STAZH 1445\87

Treguesit shqisorë:

1.*Pamja:* E njëtrajtshme, pa shtresa, në prerje e sipërfaqe të shënditura pa pika uji dhe mbeturina dhalli.

2.*Ngjyra:* Krem deri në të verdhë të çelur.

3.*Era dhe shija:* E këndshme, karakteristike e gjalpit pa erë dhe shije të huaj.

Treguesit kimik:

Lageshtira në % ,jo me shumë se 17.

Lëndët e thatë pa yndyr në e %, jo më shumë se 2.

Kripë në %, jo më shumë se 2 gjalpi i kripur.

Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shendetesise.

Amballazhimi: Ambalazhohet në kuti kartoni të valëzuar me masë 1- 5 kg, të veshur nga brenda me letër pergamen.

Mbi çdo ambalazh me gjalpë vendoset etiketa në të cilën shënohen: Emërtimi i prodhuesit ,Emri i produktit, Pesha neto ose vëllimi i produktit, Data e prodhimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga

ambalazhi. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë. N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës origjinale.

Malli të shoqërohet me fletë analize laboratorike, certifikatë orgjine.

Ruajtja dhe transportimi: Gjalpi ruhet në frigorifer në temperaturë 2-4 °C,

Transportimi i gjalpit nga një rreth në tjetrin bëhet me mjete frigoriferike. Transportimi bëhet me mjet të mbuluar e të pastër, i cili është i destinuar për transportimin e prodhimeve ushqimore.

Djath i bardhe -Kerkohet cilesia e pare prodhim vendi me baze djath nenprodukt i qumeshtit te lopes,deles ose dhise.

Nuk lejohet prodhim i djathit me perzjerje qumesht pluhur.

Ngjyra sipas llojit te qumeshtit qe prodhohet djathi,nga qumeshti lopes ngjyre krem ,nga qumeshti i dekles dhe dhise –ngjyre te bardhe ne krem. –Lejohet djathi me perqindje yndyre jo me shume se 3% yndyre.Pamja e jashtme te jete konforme ,ne brendesi poroze,karektweristike e djathit te stazhionuar mire.

Era karakteristike e djathit normal pa era te tjera te pa kendshme .

Amballazhimi te jete ne rrota te parafinuara 3-5 kg

Malli te jete i shoqeruar me certifikate te cilesise dhe standarteve te miratuara.

Ne etikete te jete shenuar data e prodhimit,date e stazhionimit dhe data e skadimit,ne certifikate te jete shenuar edhe origjina e mallit.

Public Health Sector

VEZE PULE bazuar ne STASH 1515-85

Treguesit cilësorë vezës së pulës:

1. *Pamja e jashtme*:E pastër dhe pa plasje.Lejohen ndotje të lehta.

2. *Dhoma e ajrit*:Lartësia, jo më shumë se 9 mm.

3. *E bardha e vezës*:E dendur e kulluar dhe e pastër pa njolla gjaku (të kontrolluar në ovoskop).

4. *E verdha e vezës*:Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e lëvizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qendror.

5. *Era*:Pa erë prishje dhe erë tjetër të huaj.

6. *Masa*: Jo më pak se 40 gr.

AMBALAZHIMI:Vezët ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 vezë secila dhe në çdo kuti kartoni vendosen 12 copë kartona fole.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen. Emri i ndërmarrjes prodhuese, sasia, data e prodhimit.

Loti 3. Blerje ushqime koloniale

MAKARONA

Treguesit shqisorë:

1.Forma:Te ndryshme

2.Pamja e jashtme:

Në formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër. Mbas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.

3.Ngjyra:

E bardhë me nuancë të verdhë, në thyerje paraqiten qelqore në jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.

4.Era dhe shija:

E mirë, karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe për çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi:

Në qese telefoni me masën 500 gr, këto të future në kuti kartoni deri 12 kg. Në amballazhin 500 gr të jetë shënuar dhe afati i skadencës jo më pak se 1.5 vjet.

ORIZ

Treguesit shqisorë:

1.Pamja e jashtme:

Kokrra të shëndosha, të pastëra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije, pa shënja myku ose prishje.

2.Ngjyra:

E bardhë, lejohen kokrra me nuancë ngjyrë të verdhë.

3.Era dhe shija:

Karakteristikë e orizit të shëndoshë pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi:

Të jetë me pako prej letre 1 kg neto. Në amballazhin të jetë shënuar edhe afati i skadencës.

SHEQER

Treguesit shqisorë:

1.Pamja e jashtme:

pluhuri i përbërë nga kristale të imët dhe të njëllojtë pa lëndë të huaja, të jetë i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet, pa copa sheqeri të ngjeshura ose lëndë të huaja.

Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

2.Ngjyra:

e bardhë dhe me shkëlqim.

3.Era dhe shija:

shije e ëmbël, pashije dhe erë të huaja, kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.

4.Tretshmëria:

tretet plotësisht në ujë, tretshmëria e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

Treguesit kimik:

Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi:

Të jetë me pako prej letre 1 kg neto. Në amballazhin të jetë shënuar edhe afati i skadencës.

VAJ GATIMI

Treguesit shqisorë:

1. *Pamja*: Lëng vajor, i artë, pa depozitime.

2. *Ngjyra*: E verdhë, e lehtë.

3. *Era dhe shija*:

E mirë, karakteristike e vajit të lulediellit të rafinuar, pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi dhe etiketimi: Vaj luledielli i rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 litërshë, të mbyllur me tapë plastike me vidhëzim hermetike të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse.

Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet:

- Emërtimi i plotë i mallit.
- Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion.

Vaj Ulliri

Treguesit shqisorë: 1. *Pamja*: Lëng vajor, pa depozitime. 2. *Ngjyra*: Në ngjyrë ulliri, e lehtë. 3. *Era dhe shija*: E mirë, karakteristike e ullirit, pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi dhe etiketimi: Vaj i ullirit do të ambalazhohet në shishe plastike ose qelqi me vëllim 1 litërshë, të mbyllur me tapë plastike me vidhëzim hermetike të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet: - Emërtimi i plotë i mallit. - Data e skadimit ose afati i përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e furnizimit në institucion.

NISESHTE

Të jetë e cilësisë së parë, e stazhionuar, e ambalazhuar në pako 1 kg letre, ku të shënohet:

Emërtimi i prodhuesit, Emri i produktit, Peshë neto ose vëllimi i produktit, Data e prodhimit
Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

SALCË DOMATE

Treguesit shqisorë:

Pamja e jashtme: Masë pastoze, me pjesë të dukshme të përbërësve të saj, pa pjesë të djegura.

Ngjyra: E kuqe deri e kuqe e thellë.

Shija dhe era: Me shije dhe erë karakteristike të salcës së domates.

Treguesit kimik: Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Amballazhimi: Salca e domates ambalazhohet në kanaçe metalike 400 gr.

KRIPE E JODIZUAR bazuar në STAZH 1437\01.07.1995

Treguesit cilësorë:

1. *Ngjyra*: E bardhë

2. *Era dhe shija*: E kripur pa shije dhe erë të huaj.

3. *Pamja e jashtme*: Masë kokrrizore

Treguesit fiziko kimik: 1-Imtësia në mm 0.2 – 2. 2-Klorur Na në lëndën e thatë në %, jo më pak

se 98.

3- Klorur Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

4-Sulfat Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.9.

5-Sulfat Ca në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.2.

6-Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

7-Lagështirë në %, jo më shumë se 1.

8-Jodur kaliumi mg/kg 50 (+/-) 3

Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjieno shëndetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetsisë.

Markërimi: Emërtimi i prodhuesit Emri i produktit Pesha neto ose vëllimi i produktit Data e prodhimit Data e skadimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Ambalazhimi: Të bëhet në qese të pastër ose polietileni ushqimorë, pako me masë 500 gr.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpëputet nga ambalazhi. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.

Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raport analize të laboratorit

Recel frutash, kokerr, i ambalazhuar me ene hermetike dhe pa papasterti, duhet të jenë sipas standartit shtetëror të ambalazhuara në vazo 1 kg. me etiketim të rregullt ku të lexohet qartë prodhuesi, data e prodhimit, skadenca ku afati i skadences të jete mbi 9 muaj nga data e furnizimit, si dhe përmbajtja e tyre.

Treguesit shqisore Pamja e jashtme

Biskota me forme të ndryshme, me sipërfaqe abrazive. Ngjyra e biskotave varion në kafë të hapur dhe të verdhë. Aroma varion nga ato me vanilje si dhe aroma të tjera duke eliminuar aromat e pakëndeshme dhe aromat e mykjes. Treguesit kimike : Në përputhje me standartin shtetëror Shqiptar Paketimi: Me ambalazh të masës 100gr. Në paketim të jete shënuar dhe afati i skadences.

Caj limoni, kokerr, me paketim 300 gr . Në paketim të jete shënuar dhe afati i skadences.

Loti 4: Blerje mish vici

MISH VICI

Treguesit shqisorë:

1.Pamja e jashtme:

Me ngjyrë në rozë karakteristike e mishit të Vicit me moshë 1-2 vjec, . Muskulatura të jetë e plotë, karakteristike e mishit, cilësi e parë .

2.Ndarja anatomike:

Mishi do të ketë keto tregues.

*3.Era:*E këndshme, karakteristike e llojit.

5.Lëngu i mishit pas zierjes:

I tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyre.

Treguesit kimiko mikrobik:

1.Azot i tretshëm, në mg, Amonjiak (NH₃) për 100 gr product jo më shumë se 20.

2.Aciditeti i shprehur në ph 5.2 deri në 6.4.

3.Reaksioni për hidrogjenin sulfuror negativ.

4.Ngarkesa mikrobike brenda normave të miratuara nga (AKU). Treguesit kimik e mikrobik analizohen vetëm në ato raste kur dyshohet për ndryshimet që ka pësuar mishi.

Kontrolli veterinar:

Secila pjesë e mishit duhet të ketë vulën e kontrollit veterinar dhe të transportohet me mjete të kontrolluara. Çdo parti mishi shoqërohet me certifikatë veterinare. Vula e raporti veterinar të jenë të lexueshme mirë..

Treguesit kimik:Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar.

Loti 5: Blerje mish pule (kofshe pule)

Mishi i pulës (kofshet e pulës) të jetë i freskët, prodhim vendi (shqiptar), cdo cope duhet të jetë je me shumë se 150 gr, të jenë në brenda standarteve shtetërore dhe të certifikuar për konsum. Me erë të këndshme, karakteristike e llojit. Pamja e jashtme të jetë me sipërfaqja karakteristike të mishit të pulës dhe me ngjyrën karakteristike të tij.

Çdo parti mishi shoqërohet me **certifikatën veterinare dhe të cilësisë**, me të cilën vërtetohet gjendja e tij e mirë shëndetsore për shitje në treg (për konsum).

Furnizimi do të kryhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri në magazinat e blerësit.

Loti 6: Blerje perime

PATATE - Bazuar në STASH 1729\88

Treguesit cilësorë të patates verore e dimërore:

1. Pamja e jashtme:

Të plota, të forta, të pastra e të thata , jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipik të kultivarit.

2. Pjekuria:

Kokrra të pjekura.

3. *Madhësia e kokrrës (diametric më i madh) mbi:*

për të rrumbullaktat dimërore – 5 cm; verore – 4 cm.

për vezaket dimërore dhe verore – 4 cm.

për të zgjaturat - 3.5 cm.

4. *Lejohen:*

a. lehtësisht të gjelbra jo me shume se 3 % për dimëroret; 1 % për veroret;

b. të mbira jo më shumë se 1 % për dimëroret dhe nuk lejohen për veroret;

c. lehtësisht të vyshkura jo më shumë se 3 % për dimëroret dhe 2 % për veroret;

d. të çara, të prera e të plasura nga goditjet nuk lejohen;

e. të kalbura nga lagështira vetngrohja, fitoftora, bryma, ngrica, nga sëmundje e dëmtues nuk lejohen;

f. zgjebe me plagë deri në 1\5 e sipërfaqes së kokrrës jo më shumë se 1 %.

g. njolla bojë hiri e ndryshkur deri në 1\5 e sipërfaqës së kokrrës nuk lejohen;

h. dëmtime nga krimbi jo më shumë se 1 % .

i. Dëmtime nga doseza nuk lejohen.

Bazuar në STASH 1789\88

Kokrra të pjekura për patatet verore lejohen me lëkur që hiqen.

Për patatet dimërore nuk lejohet që lëkura të ndahet nga tuli.

Të pastra në sipërfaqe me formë ,ngjyrë e sytha tipik të kultivarit.

Nuk lejohen kokra me ngjyrë jeshile, të vyshkura, të mbira, të çara, të plasaritura në sipërfaqe dhe të prekura në pjesën e tulit.

Përsa i përket pures së patates ajo duhet të ketë treguesit e mësipërm të patates, dhe duhet të jetë e pakeluar në qese të vendosura në kuti kartoni, ku të tregohen treguesit fiziko kimik 350-750 gr.

QEPE bazuar në STASH 1755\88

Treguesit cilësorë të qepës së njomë dhe të thatë:

1. *Pamja e jashtme:* Me pjekuri të plotë.Me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota.Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.

2. *Diametri (madhësia e kokrrës):*për ovalet 4-8 cm.për llojet e tjera 5-10 cm.

3. *Dëmtime mekanike:*Cifla, bishta, sëmundje, lejohen jo më shumë se 1 % e parties me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja (cifla, bishta).

4. *Me sëmundje:*Nuk lejohen.

5. *Të ngrira,të kalbura e të mykura:*nuk lejohen

KARROTA

Treguesit cilësorë të karrotës:

1. *Pamja e jashtme:*

Të freskët me ngjyrë të verdhë në të kuqerremtë, formë tipike të kultivarit, me përkulje të lehtë, të jenë të pastruar me ujë të pijshëm nga balta.

2. *Përbërja e brendshme e tulit:*

Me tul të fortë, me bosht të hollë, me diametër jo më shumë se 1 cm.

3. *Madhësitë:*Gjerësia (diametric me i madh)deri në 4 cm, Gjatësia 10 -15 cm.

Dëmtime mekanike (gërvishtje të lehta në lëkur) në % jo më shumë se 2.

4. *Të prekura nga sëmundjet, insektet e të kalbura:*Nuk lejohen.

SPINAQ

Treguesit cilësorë të spinaqit:

1. Pamja e jashtme:

I freskët i pastër i njomë, me ngjyrë të jeshile, i pavyshkur dhe i larë me ujë të pijshëm.

- Gjatësia e gjethit jo më shumë se 15 cm.

2. Dëmtime e sëmundje:

Nuk lejohen njolla ndryshku, nga antraknoza, ndezje e kalbje. Lejohen të vrara 5%.

DOMATE - Bazuar në STASH 1726-88

1. Pamja e jashtme: Të fresketa, me forme tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pavrara, të pashtypura, pakalbje dhe pa njolla nga djegia e diellit, të paprekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të palagura.

2. Pjekuria dhe ngjyra

Me pjekuri normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate të tejpekura, të zbutura e të vyshkura.

3. Dëmtime e sëmundje: Nuk lejohen.

4. Të palsura e të vrara lehtësisht:

Për llojet e mesme dhe të vona lejohen deri në 5% plasaritje rreth bishtit por pa rrjedhje lëngu (të kalçifikuara), madhësia e kokrrës (diametri më i madh gjerësor), jo me pak se:

Për të hershmet 5 cm.

Për të mesmet dhe të vonat 7 cm.

Për të mesmet e të vonat kumbullore (gjatësia 5 cm).

B I Z E L E- Bazuar në STASH 1713-88

Treguesit cilësorë të bizeles kokërr:

1. Pamja e jashtme

Të njoma, të freskëta, të pastra e të paçara, me ngjyrë të kultivarit, me pjekuri teknike dhe madhësi normale të kultivarit.

2. Dëmtime mekanike

Njolla ndryshku nga antraknoza, ndezje e kalbje, nuk lejohen.

Treguesit cilësorë të bizeles bishtajore:

1. Pamja e jashtme

Të fresketa, të njoma, të pastra, të pathyera, me ngjyre e madhësi të kultivarit.

2. Kokrrat në bishtaje Me madhësi normale të kultivarit, të zhvilluara mirë në fazën qumështore, me ngjyrë jeshile të hapur, me lekure të hollë, të njomë e të embël, pa shenja drunjëzimi.

3. Dëmtime mekanike Njolla ndryshku, nga antraknoza, ndezje e kalbje. Lejohen të vrara 5%.

LAKER bazuar në STASH 1758-88

Treguesit cilësorë të lakrës:

1. Pamja e jashtme:

Të zhvilluara, me mbështjellje fletesh, e forte ne prekje. Lejohen lakra të pangjeshura deri 2% të parties

2. Pastrimi dhe gjatësia e koçanit:

Të jene të pastruara dhe me 2-3 gjethe të gjelbera, të lidhura me koçanin i cili të jete deri ne 3cm.

3. Dëmtime të ndryshme mekanike:

Sëmundje e të çara të lehta. Lejohen deri ne 2% e parties me dëmtime të lehta mekanike, të çara lehtësisht e të shpërthyer si dhe të dëmtuara lehtësisht nga bryma.

4. Me sëmundje:

Nuk lejohen.

5. Pësja e kokrrës :

-Për lakrën e hershme, jo më pak se 1 kg .

-Për lakrën me pjekje të mesme e të vona, jo më pak se 1.5 kg.

-Për lakrën tip “Drinishti” hibride etj, jo më pak se 0.8 kg.

PATLIXHANE - Bazuar në STASH I730\88

Treguesit cilësorë të patëllxhanit:

1. Pamja e jashtme:

Karakteristike e kultivarit, të fresketa, të pastra, me sipërfaqe të lëmuar me ngjyrë të zezë manushaqe me pjekuri normale me fletë jeshile me nuanca të dobëta manushaqe, të pa vyshkura.

2. Dëmtime e sëmundje:

Nuk lejohen.

3. Të kalbura, të mykura, të ngrira

Nuk lejohen.

4. Madhësia:

a) diametri jo më shumë se:

Për të gjatat 5 cm;

Për të rrumbullaktat 12 cm;

gjatësia e bishtit jo më shumë se 4 cm.

KUNGULL

Treguesit cilësorë të kungullit:

1. Pamja e jashtme:

Karakteristike e kultivarit, të fresketa, të pastra, me sipërfaqe të lëmuar me ngjyrën e vetë natyrale me pjekuri normale të pa vyshkura.

2. Dëmtime e sëmundje:

Nuk lejohen.

3. Të kalbura, të mykura, të ngrira

Nuk lejohen.

BAMJE

Treguesit cilësorë të kungullit:

1. Pamja e jashtme:

Karakteristike e kultivarit, të fresketa, të pastra, me sipërfaqe të lëmuar me ngjyrën e vetë natyrale me pjekuri normale të pa vyshkura.

2. Dëmtime e sëmundje:

Nuk lejohen.

3. Të kalbura, të mykura, të ngrira

Nuk lejohen.

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në

mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.



Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti 1 : Blerje buke gruri

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA E PRITSHME
1	Buke e bardhe e prere ne feta	Kg	1500

Loti 2: Blerje bylmet dhe veze

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA E PRITSHME
1	Qumesht	liter	4200
2	Gjalp	kg	60
3	Veze	cope	5500
4	Djath i bardhe	kg	370

Loti 3. Blerje ushqime koloniale

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	Paketimi	NJESIA	SASIA E PRITSHME
1	Makarona	paketim 500 gr	kg	600
2	Oriz	paketim 1 kg	kg	200
3	Vaj gatimi	shishe 1-3 kg	liter	200
4	Vaj ulliri	shishe 1-3 kg	liter	50
5	Sheqer	paketim 1 kg	kg	200
6	Kripe	paketim 500gr	cope	96
7	Salc	paketim 400 gr	cope	96
8	Biskota	paketim 100gr	cope	100
9	Niseshte	paketim 500 gr	kg	50
10	Recel	paketim 1 kg	kg	200
11	Caj	kuti 300 gr	cope	120

Loti 4: Blerje mish vici

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA E PRITSHME
1	Mish vici	kg	150

Loti 5: Blerje mish pule (kofsha pule)

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA E PRITSHME
1	Mish pule (kofshe pule)	kg	500

Loti 6: Blerje perime

Nr	EMERTIMI I MALLRAVE	NJESIA	SASIA E PRITSHME
1	Patate	kg	1500
2	Qepe	kg	1000
3	Karrota	kg	200
4	Spinaq	kg	50
5	Kunguj	kg	50
6	Domate	kg	50
7	Bamje	kg	50
8	patellxhane	kg	50
9	Bizele	kg	50
10	Laker	kg	50

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës me kerkese e autoritetit kontraktor.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumentat Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

Procedura e prokurimit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
----------	-------

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që

kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intellektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikave, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së

mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
